

## Procesverbal

Nga seanca e V-të(pestë) e rregullt e Kuvendit të Komunës së Dragashit, e mbajtur më 10.03.2022, me fillim nga ora 10.00, me këtë:

### *R e n d   d i t e*

- 1.Dhënia e betimit të anëtarit të zëvendësuar nga KQZ-ja z.Edin Kurt,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i proces verbalit nga seanca e III-të
- 3, Miratimi i Planit të punës së Kuvendit Komunës për vitin 2022,
- 4, Rishqyrtimi i Vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Sigurinë Bashkësi(KKSB),
- 5, Themelimi i Komisionit të Aksionarëve në ‘Eko-Regjioni’ në Prizren,
6. Lista e përgjithshme e pronave të Komunës,
7. Lista e veçantë e pronave të komunës që do të jepen në shfrytëzim për vitin 2022,
- 8, Eventuale.

Seancën, me përshëndetjen e të pranishmëve... e hapi kryesuesi i KK-së z. Uran Halimi, me kërkesën dhe deklarinimin e delegatëve, ku edhe e lexoi rendin e ditës nëse ka vërejtje apo plotësime të rendit të ditës, Kryetari e ka fjalën në lidhje me rendin e ditës

**z.Bexhet Xheladini-** para se asambleja të vazhdoj me rendin e ditës desha me i sqarua disa gjera lidhur me asamblenë e kaluar ku ju e dini se z. Edin Kurt ju mohua e drejta për të dhënë betimin e drejt e cila buron nga e drejta e votës, dhe për këtë çështje jam drejtuar edhe MAPL-së me një shkresë dhe kam lypë sqarime dhe kam kërkuar që në këtë mbledhje të jetë edhe një përfaqësues i Ministrisë, MAPL-ja më është përgjigjur me një shkresë përmbajtja është se kryetari i Komunës dhe Kryesuesi duhet të ndër marrin veprimet e nevojshme për thirrjen e mbledhjes për dhëniën e betimit të anëtarit të ri të kuvendit z.EDIN KURT dhe ftesa duhet të përmbaj edhe dhenien e betimit të këtij anëtar dhe ky anëtar është pjesë e kuoromit dhe gjithashtu e miraton rendin e ditës, gjithashtu në këtë shkresë thotë se anëtar i Kuvendit ka të drejtë të bëjë kuorumin dhe ta votoj rendin e ditës, ky është një sqarim nga ana ime me qëllim të mos përsëritjes së ngjarjes nga mbledhja së kaluar.

**z. Uran Halimi** – pasi po kërkohet edhe nga ana ime, kish qenë mirë që të kërkohet sqarim nga MAPL-ja një mendim për seancën e jashtëzakonshme, pasi që z.Edin Kurt në seancën e rregullt duhet me e bo betimin edhe do ta bëjë, mirëpo këtë kërkesë kishte qenë mirë me ja pas bo për seancën e kaluar pasi në këtë seancë do ta bëjë betimin.

**z. Naser Myrtezani-** Kryesues unë kërkoj nga ju që ti përmbaheni rregullores së kuvendit ku për çdo pikë të rendit të ditë delegatët kanë të drejtë të japin opinionet e tyre por vetëm një herë dhe vetëm për atë pikë, dhe po qese ka dikush të japë opinion tjetër është e paraparë pika eventuale.

**z. Uran Halimi** - pasi e lexuam rendin e ditës kush është pro rendi të ditës, kundër nuk ka dhe apstenim nuk ka.. miratohet me 27 vota rendi i ditës.

#### **Pika e I-rë (parë) e rendit të ditës**

**z. Uran Halimi** - e ftoj z. Edin Kurt që ta bëjë betimin

**z. Edin Kurt** – Lexon betimin...

#### **Pika e II-të (dytë) e rendit të ditës**

Vazhdojmë me pikën e II-të të radhës ku kemi shqyrtimin dhe miratimin e proces verbalit nga seanca e kaluar, kush donë me e marr fjalën, fjalën e ka z. Munir.

**z. Munir Jonuzi**- Në faqen 7, paragrafi i fundit në versionin e gjuhës së komunitetit joshumicë, më janë shtuar fjalë që nuk i kam thënë unë. Ky është një gabim teknik. Kërkoj nga shërbimi i Kuvendit të korrigjojë gabimin.

**z. Uran Halimi** - çoftë se nuk ka dikush tjetër të shtoj kush është pro proces verbalit sipas propozimit të z. Munirit... Miratohet procesverbali me 27 vota pro, 0 kundër dhe 0 abstenim

#### **Pika e III-të (tretë) e rendit të ditës**

**z. Uran Halimi** - kush donë me e marr fjalën rreth kësaj pike. Fjalën e ka z. Shpëtim Hajredini.

**z. Shpëtim Hajredini**- në seancën e V-të të rregullt do të diskutojmë dhe votojmë për planin e punës të Kuvendit të Komunës për vitin 2022. Plan i cili më ngjason me atë të viteve të kaluara, mirëpo me rëndësi është që të punojmë për të mirën e qytetarëve, unë personalisht por edhe si grup ju sigurojmë se secili projekt që do të silllet nga ekzekutivi dhe ka të bëjë për të mirën qytetarëve ne do të ju mbështesim por asnjëherë mos mendoni që të punoni diçka që është kundër mirëqenës së qytetarëve. Ne u kemi kërkuar votën e qytetarëve që të punojmë për ta dhe ne jemi këtu fal votës së tyre dhe të punojmë për ta por jo vetëm para qytetarëve por llogari do të u japim edhe para krijuesit së gjithësisë andaj për këtë barrë të rëndë që kemi dhe që e kemi pranuar me dëshirë duhet me dhënë llogari para qytetarëve dhe për këtë ne së bashku edhe si opozitë edhe pozita do të bashkohemi të punojmë dhe të ndryshojmë gjendjen në të mirë të qytetarëve.

**z. Uran Halimi** - kush dëshiron me e marr fjalën... në çoftë se jo atëherë e qesim ne votim planin e punës për vitin 2022, Kush është pro...me 27 vota pro miratohet.

#### **Pika e IV-të (katërt) e rendit të ditës**

**z. Uran Halimi** - për këtë pikë e ftoj kryetarin e Komunës që ta merr fjalën.

**Bexhet Xheladini**- Në seancën e mbajtur më datë 08.02.2022 përveç tjerash është miratuar edhe KKSB-ja (Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi) dhe ky vendim që e ka marr asambleja është shqyrtuar

nga MAPL-ja dhe i ka marr 3 vërejtje, njëra vërejtje ka qenë se neve nuk i kemi përfaqësuar të 3 komunitetet me këtë vendim, vërejtja dyte është se i kemi vendosur dy përfaqësues të Bashkësisë Islame dhe vërejtja e tretë është se i kemi vendosur dy përfaqësues të Policisë, pas shkresës që ja kam dërguar unë ministrisë dhe pas konsultimeve tjera që kam pasë me ta kam sqaruar se në Komunën tonë bashkëjetojnë 3 komunitete ata kanë menduar se jetojnë edhe komunitete tjera, çështje tjetër se me vendim të Këshillit të Bashkësisë Islame të Kosovës janë të themeluara 2 bashkësi islame në Komunën tonë njëra është KBI-Dragash e tjetra KBI – Gora dhe sqarimi tret ka qenë se na jemi Komunë e cila kufizohemi me dy shtet dhe përveç komandantit të stacionit policor na e kemi edhe një komandant të vijës së gjelbert i cili në bazë të hierarkisë nuk i përgjigjet komandantit policor të Dragashit por asaj rajonale të Gjakovës, pas këtyre sqarimeve që i kemi bërë na në ministri i propozoj këtij Kuvendit që ky këshill të mos të ndryshojë por të mbetet ai i datës 08.02.2022.

**z. Nexhmudin Sejdiç**-- Përshëndetje të gjithëve, i nderuari Kryetar, ju kam dëgjuar më vëmendje për këtë Këshill, meqë ju po kërkonte të marrim të njëjtin vendim si herën e kaluar, nuk keni pasur nevojë ta vendosni në rend dite. Ju vetëm mund t'i shpjegoni MAPL-së për paqartësitë dhe se ai nuk ka pse të vijë në kuvend për të konfirmuar të njëjtin vendim që MAPL më herët e kishte shpallur të paligjshëm.

**z. Shpëtim Hajredini**- një pyetje për Kryetarin, në legjislaturat e kaluara pjesë e këshillit ka qenë edhe komandanti i zjarrëfisave e cila ndikon direkt në sigurinë e popullatës pse është larguar? Dhe propozoj që të largohet dikush tjetër dhe të futet ky.

**z. Bexhet Xheladini** - Unë vendimin e kaluar e kam pa dhe nuk ka qenë Komandanti, dhe nga MAPL-ja kanë qenë këto 3 vërejtje nuk ka dhënë vërejtje tjera, dhe unë propozova që ky vendim të mos ndryshohet pasi që e kemi një realitet tjetër në Komunën tonë, pasi që MAPL-ja e na ka dhënë shansin me e rishqyrtuar këtë vendim dhe ju mund ta rishqyrtoni këtë vendim dhe me e prur vendim meritor, propozimi im është ai që e dhashë ma herët.

**z. Uran Halimi** - Desha ta jap një sqarim tek përfaqësuesi i zjarrfikëseve, sipas kërkesës së z. Hajredini se ma herët në këtë ekip ka qenë përfaqësuesi i ekipit për siguri në bashkësi, ku me këtë rast e kemi z. Zeni Krasniqin ku i njëjti e ka rrolin e kryesuesit në siguri në bashkësi siç e kërkon udhëzimi i MAPL-së.

**z. Artian Loshaj**- Kryetar ne jemi për themelin e KKSB-së, por dje ne Komitet na thajë se pas kësaj shkrese ke biseduar në telefon dhe ke marr pëlqimin të thirrret kjo seancë, dhe ju të njëjtën e keni prur sot, unë e di që i ki votat edhe e kalon këtë por prapë Ministria ka me na kthyer prapë, unë e kamë një shqetësim tjetër që tet seanca që jemi këtu ne i kemi marr 2 vendime edhe ato 2 vendime na janë kthyer prapë nga MAPL na ka kthyer prapë njëra për byfenë e tjetra për KKSB-në ne me këtë legjislaturë i kemi 4 vite dhe të jeni ma sy hapur qe se si të fillojmë me fillim me na kthye të gjitha vendimet, unë e di që jeni kon për shumë gjatë në opozitë dhe keni vullnet me punuar por të jeni ma sy qel qe të bini vendime që ja vlen me votu.

**z. Naser Myrtezani-** Kërkojmë që kjo pikë e rendi të ditës të hedhet në votim.

**z. Uran Halimi** - Se a do të hedhet në votim a jo unë jam ai që vendosi, e jo ju, un sikur kishe me na thënë diçka rreth temës. Votojm, kush është pro propozimit të kryetarit me ndryshimet që i ka propozuar kryetari. I kemi 14 vota pro, 10 kunder 3 abstenime, kalon vendimi për KKSB.

#### **Pika e V-të (Pestë) e rendit të ditës**

**Znj. Xhyferie Batijari-** siç e keni edhe në materialin e pikës së V-të të rendit të ditës për themelimin e komisionit të aksionareve ne propozojmë që në këtë komision të janë z. Naser Myrtezani dhe z. Mehmet Spahiu.

**z. Shpëtim Hajredini-** pasi që ju veç numrat i keni dhe propozimet vet i vini i votoni sipas dëshirës, por nuk po e di se sa është morale që një grup i opozitës prej 10 anëtarëve mos ta ketë mundësin të ketë një anëtarë, prandaj propozoj që nga PDK-ja ta ketë një anëtar.

**z. Uran Halimi** - E hedhim në votim propozimin e znj. Batjari, Kush është pro ... 14 vota pro, kundër 10 vota kush abstenon 3 abstenime prandaj miratohet propozimi i zonjës Batjari.

#### **Pika e VI-të (Gjashtë) e rendit të ditës**

**z. Uran Halimi** - Kjo pikë ka të bëjë veç me publikimin e pronave komunale në web faqe, pra nuk ka të bëjë me dhenien në shfrytëzim por veç me publikimin.

**z. Shpëtim Hajredini-** kam një kërkesë për sqarim në listë e kemi emrin, numrin e parcelës dhe vendin, dhe nuk kemi diçka tjetër shtesë , ketë që e sqarove ti është dashur të na dërgojshe edhe neve që kjo listë thjeshtë si është do të del në web faqe pik.

**z. Uran Halimi** - me qenë se dje në KPF- e kemi pas një kërkesë të këtij lloji e ftoj Drejtorin për Ekonomi dhe Financa të na japë një sqarim rreth kësaj pike.

**z. Qamil Kolloni-** kisha pas dëshirë të i marr të gjitha pyetjet por pasi dola po i përgjigjem Shpetimit, lista e pasurisë së K.K është dashur të jetë e publikuar me 31 12.2021 në Web Faqën e Komunës, përveç kësaj liste është dashur të jetë e publikuar edhe lista e veçantë e pasurisë së paluhatshme e cila jepet në shfrytëzim në interes të Komunës, me qenë se këto dy lista për shkaqe zgjedhore apo neglizhencë të qeverisë së paraprake neve na ka ardhur një urdhëresë nga MPL që kjo të shtyhet deri me 31 dhjetor ne e kemi prurë këtë listë me pronat komunale të cilat i kemi gjetur në listat ekzistuese dhe po mundohemi ti bëjmë publike në të ardhmen, pra ne e kemi marr një afat kohor deri në 31 mars që ti bëjmë publike dhe paraprakisht këtë duhet të kaloj nga Kuvendi.

**z. Uran Halimi** - e hedhim në votim, kush është pro këtij propozimi, miratohet me 27 vota pro, 0 kundër dhe 0 abstenim.

## **Pika e VII-të (Shtatë) e rendit të ditës**

**z. Uran Halimi** - në këtë pikë për dallim nga lista e përgjithshme këtu e kemi listën e veçantë që do të jepet në shfrytëzim në të mirë të Komunës dhe qytetarëve.

**z. Samidin Xheladini**- për hir të transparencës dot të ishte mirë që këto lista të janë sipas numrit të parcelave ku ne nuk e dimë se ku janë mirëpo kur të publikohen mund ta dimë se ku janë me emra me adresa, është mirë që drejtoritë përkatëse dhe punëtorët ti kryejnë këto punë se ku janë lokacionet.

**z. Uran Halimi** - A është propozim i juaji ky apo? Z. Xheladini po është propozim i im.

**z. Agron Gashi**-desha pak të kyçem në këtë pikë , për qeveritë e kaluara dhe që do të ishte mirë edhe në të ardhmen. Qeverisja paraprake dhe auditorët që na kanë vizituar kanë gjetur shumë të për pasurin ku janë gjetur diku 109 ndërsa tash figurojnë 114 në pronësi Komunale e që janë dhënë në pronësi ndërsa auditori i gjen vetëm 28 për afërsisht 30 kontrata të rregullta, ndërkaq 80 kontrata tjera ose kanë qen të skaduar ose nuk kanë ekzistuar fare, andaj rekomandimet e auditorit ishin se komuna është dëmtuar shumë në buxhet por edhe si ndihen ata shfrytëzues të rregullt sipas kontratave dhe sipas ligjit dhe të tjerët nuk paguaj fare, prandaj po konsideroj se qeverisja e re të jetë transparente ndaj qytetarëve dhe tash edhe si ekzekutiv por edhe legjislativ që të ketë një mbarëvajtje të mirë dhe të jemi ma sy qel në këtë drejtim.

**z. Qamil Kolloni**- një pjesë e delegatëve që kanë qenë ma herët e din por këta të ri po bëjnë pyetje, desha të i përgjigjem Samidinit se këto janë prona Komunale që ju takojnë ose personave fizik ose operatoreve ekonomik, por të cilët ose nuk kanë kontrata ose kanë kontrata të skadume ose kanë kontrata të rregullta e të cila numri tyre është tepër i vogël, sa i përket pronësisë dhe listës së pronësisë është çështje e agresionit të pronave të Komunës, Kadastrit, Urbanizmit, ndërsa Drejtoria e Financave merret me listat ekzistuese për grumbullimin e borxheve apo inkasimin e tatimit, për këtë arsye K.K Dragash ka marrë një vendim me datën 07.05.2021 ka marr një veprim ku ka dërgua shkresa për të gjithë borxhliet e Komunës ku sipas të gjitha të dhënave Komuna nuk ka ndërhy në grumbullimin e të gjitha të hyrave dhe ka borxh diku 297.0000,00 euro që janë të dhëna zyrtare. Për këtë qellim gjatë fushatës zgjedhore klientëve ju është bërë presion ku jon dërguar shkresa se borxhet do të grumbullohen nëpërmjet përmbaruesit privat, gjë që i ka vu në presion. Mirëpo në muajin e 8 pra me 17.08.2021 merr vendimin tjetër për llogarit e arkëtueshme ku e parasheh një afat kohor për shlyerjen e borxheve dhe njëkohësisht kjo nuk len hapësirë për veprime tjera juridike. Duhet të ja u lexoj nenin.... deri me 30.09.2021 Komuna do të inicioj procedurat gjyqësore dhe përmbarimore për inkasimin e detyrueshëm përmes përfaqësuesit ligjor të autorizuar të Komunës për të gjitha bizneset dhe personat fizik që kanë obligime në emër të komunës dhe taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste si dhe shfrytëzuesit e pronës Komunale, pra në bazë të këtij vendimi ne nuk kemi të drejt të bëjmë asnjë veprim juridik, çka do të thotë kjo, kjo do të thotë se pas një vendimi i cili ka qenë kërcënues para fushatës zgjedhore pas fushatës është bërë një popullizëm ku në këtë vendim parashihet falja e 40% e borxheve nga bizneset të cilët nuk e kanë shfrytëzuar deri me tash, me vullnetin dhe iniciativën e Kryetarit do të bëjmë përpjekje maksimale që deri në muajin e 9 që kanë obligime ndaj Komunës që ti largojmë nga një procedurë e rëndë përmbarimore apo me ballafaqimin me gjykatën, por këto vendime na bëjnë të

pamundur të marrim veprime juridike, ne do ti qojmë edhe shkresa me vendimin paraprak që do ti sanksionoj të gjithë borxhlinjtë dhe do të bëjmë përpjekje bashkërisht me këtë Kuvend që të bashkëpunojmë me ata qytetar që ti nxjerrim nga një situatë vicioze dhe mbas atij vendimi jemi të detyruar ta ekzekutojmë në muajin e 9 në qoftë se nuk arrimë të i inkasojmë atëherë lënda shkon në gjykatë pasi që gjykata ekonomike e parasheh se zyrtarët Komunal me vetëdije apo pa vetëdije e kanë shmang mbledhjen e borxhit. Ne do të mundohemi deri në muajin e 9 të gjithë personat fizik dhe operatorët ekonomik të shmangim nga kjo përgjegjësi. Unë për këtë fakt mendoj se kjo nuk është përfundimtare pasi një pjesë e mirë është mbajtur nën sirtarë, kjo nuk i takon Drejtorisë së Financave të merret me këtë punë por i takon tjetër kujë të merret me këtë çështje. Këtu i kemi 3 lloj të listave të cilat borxhet janë të evidentuara deri në vitin 2021. Deri sa ekzistojnë këto lista ne nuk mund të bëjmë asgjë prandaj unë kërkoj një maturi dhe kohë që veprimet tona të janë konformë interesave të të gjithëve dhe në mbrojtje të qytetarëve.

**z. Uran Halimi** - me duhet ta marr fjalën në emër të grupit të LVV-së, rreth këtyre borxheve, se nuk duhet të shkoj përmes gjykatave apo përmbaruesit po qytetari duhet ta din që deri sa e shfrytëzon një pronë duhet ta paguaj edhe qiranë. Cili është plani i juaj a keni plan se si të veproni në këtë rast duke i falur borxhet apo si?

**z. Qamil Kolloni**- plani konkret i joni si Q- Lokale ne mendojmë se deri në muajin e 9 ti informojmë përmes shkresave dhe të ja u bashkëngjisim edhe vendimin paraprak, dhe do të kërkojmë nga ta që para se të shkoj lënda në gjykatë ti kryejnë obligimet, pasi që ky vendim nuk na len asnjë hapësirë as me fal asnjë gjë pasi që vet vendimi i fal 49% të taksave dhe këtë të drejt mund ta shfrytëzojnë pasi ja u jep ky vendim deri në muajin e 9, ne veç mund të i njoftojmë rreth kësaj mundësie dhe në rastin e fundit të gjendet një kompromis tjetër.

**z. Uran Halimi** -pasi që i kemi edhe mediat i ftoj të gjithë këta qytetar të i përgjigjen kësaj thirrje

**z. Qamil Kolloni**-pasi që jemi sjellë në këtë gjendje me dashje apo pa dashje, por qëllimi është se bashkërisht të dalim nga kjo gjendje, unë ju kisha bërë apel të gjithë atyre që kanë borxhe të ofrohen në zyrat tona që ti shlyejnë këto borxhe sa ma herët ma mir.

**z. Nexhmirin Seldillar**-- I nderuar, ju dëgjova me vëmendje në lidhje me këto borxhe të individëve dhe përfaqësuesve të biznesit, nuk e di nëse jeni të vetëdijshëm se kemi 3 vjet që kemi një pandemi. Një gjë tjetër: a e dini se ky vend jeton sezonalisht, si mendoni për gjithë ata njerëz që janë aktualisht në krizë, a e dini sa është çmimi i naftës aktualisht apo i miellit. Si mendoni me e ekspozua të gjithë ata njerëz në një siklet nga mbledhja e detyruar. Duke qenë se keni 14 vota në Kuvend, mendoj se mund të merrni një vendim për të dal në ndihmë atyre njerëzve.

**z. Qamil Kolloni**- sa i përket pandemisë të gjithë ata muaj janë liruar nga borxhi janë kryer të gjitha nuk ka vend për popullizëm, problemi është që për 22 vite që nuk kanë paguar, Komuna ka qenë korrekt me operatorët ekonomik. Ne e kemi një vendim i cili është i formës së prerë dhe duhet detyrimisht të shkoj në përmbarim.

**z.Samidin Xheladini**- me sa po e shohim ne të gjithë jemi këtu për të ndihmuar dhe me ja dhënë kontributin me e përfundua këtë çështje, ne jemi në situata që na është trashëguar, dhe kësaj duhet ti gjenden format dhe alternativat dhe mundësit që si qytetarët të mos të dëmtohen pasi atyre ju është grumbulluar një borxh, prandaj kërkohet që bashkarisht që këtyre bizneseve që janë me borxhe me i gjetë mundësit që këto borxhe të kryhen jashtë përmbaruesit.

**z. Uran Halimi** - Është mirë që na të i informojmë qytetarët se çka i pret në qoftë se nuk i paguajnë obligimet mirëpo ne nuk jemi fajtor që për neglizhencë të tyre nuk i kanë përfunduar këto borxhe. E mirë është që ti informojmë.

**Z, Artian Loshaj**- Drejtori na tha që në muajin e 5 Komuna ja u ka bo një shkresë dhe i ka kërcënua pastaj thotë se në muajin e 8 e kemi marr një vendim, ne të gjithë si delegat për hir të pandemisë e kemi marr një vendim që për hir të pandemisë që 40% të ju falet dhe 60% të paguajnë dhe atë me një afate 1 vjeçar, si keni bërë apel sot edhe Kryetari ka bo apel dhe janë njoftuar me këtë vendim, unë e di që po doni me bo politik me ta po politik nuk bëhet me ta, se si po doni ju me pas bashkëpunim me ta edhe na e kemi pas bashkëpunim me ta, Komuna nuk i ka kërcënua por ju ka dërgue ftesë që 40 % ju falen, dhe këto që ju po i boni qytetarët veç i din, njëherë ju thoni i sanksiononi pastaj thoni se Komuna është korrekte , kjo nuk është serioze pasi ka lokale të kohës së komunizmit, këtë vendim e merrni pas shtatorit, po thoni jo nuk kemi baza ligjore, jo juridike s'kemi, nuk po na thoni konkretisht çka ..., po qoftë se po mendoni se na po i penalizojmë ata dhe po i qojmë në përmbarues, por në qoftë se jo atëherë na trego qysh ke me e bo këtë zgjedhje ti.

**z. Qamil Kolloni**- Singërisht i kemi hi punës për me punua edhe me i ik politikës, qoftë se është bo politik deri më tash na po dojmë me i ik ama ju prapë po doni me na kthye në politik, për faktin se prej 2008 ligji për dhenie në shfrytëzim të pasurisë së paluajtshme të Komunës që është miratua dhe nuk është zbatuar, dhe nuk dua të paragjykoj se a keni ra në kontakt me të njëjtët pronar të njëjtës familje dhe i bartni borxhet.

**z. Uran Halimi** – në qoftë se mundesh me na dhënë një plan konkret mos e devijoj çështjen.

**z. Qamil Kolloni**-plani është konkret që ta shfrytëzojnë pasi i është dhënë mundësia që 40% dhe kjo është e vetmja rrugë alternative që unë mund të bashkëbisedoj, mos mendo që po i politizojmë po po dojmë që këtë mundësi ta qojmë deri në fund që me i njoftuar dhe me e tejkaluar këtë situatë. Njerëzit e din edhe vinë interesohen po problemi është ma i thellë, dhe ka çështje të ndjeshme që nuk thuhet dhe jeni ju që e keni pru këtë gjendje ku njerëzit do ta shesin shpin po shkoj përmes përmbaruesit dhe këtë nuk e ka bo LDK-ja e keni bo ju 14 vjet në pushtet, me politik rrënuese ndaj qytetarit, ku pikërisht në muajin e 5 edhe 8 i keni marr këto politika ku keni mundur edhe ma herët, p.sh ne 2017 pse nuk e keni qit në tender për shkak të votave dhe jemi të vetëdijshtëm se çka keni bo, nuk po dëshirojmë me u ankuar po me punuar, dhe nuk do të ketë shmangie pasi janë mbi 2 milion euro nuk janë 2000 euro në pyetje, mos u mundoni me bo skena politike dhe me na detyrua me thënë atë që nuk kemi dëshirë me e thonë. Ne do të bisedojmë me të gjithë konkretisht drejtpërdrejt dhe do ti hapim çështjet do ti japim në shfrytëzim do të ju vazhdojmë kontratat dhe do të gjejmë gjuhen e përbashkët deri me atë datë pas asaj date nuk mund të bëjmë asgjë pasi çështja kalon në gjykatë. Kjo është përfundimtarja.

**Z, Artian Loshaj-** z. Drejtor qoftë se je i gatshme me punua e ke mbështetjen time por qoftë se po të vjen keq për qytetarët i ki votat ndryshoje mos i sanksiono, ndryshoje unë ta lypa idenë konkrete tënden qoftë se po të vjen keq e unë e di sa po të vjen keq! Atëherë e ki votën time ndryshoje dhe mos i qo qytetarët ne përmbarues, qoftë se duhet me i nxjerr 2 milion eurot edhe për 1 vjet e ki votën time jo konkretisht boni politik këtu.

**z. Uran Halimi** -Pasi ka devijuar debati dhe qoftë se keni diçka rreth listës së veçantë mund ta merrni fjalën.

**z. Agron Gashi-** Drejtori nuk dha diçka konkrete, pas pandemisë dhe luftës në Ukrainë, Ministrinë dhe Komuna duke u ndërlidhur mund të marrin vendime për ndihmë si për bujqit si për të tjerët me subvencionet. Mirëpo më duhet të kemi një qasje ligjore ku Komuna nuk mund të jetë fontanë dëshirash por është ligjore, në qoftë se këto borxhe nuk paguhen do të ishte legjitime që këto kontrata të ndërpriten, ku personat tjerë që janë të interesuar mund të vazhdojnë.

**z. Uran Halimi** - kush është pro kësaj liste që kjo listë të dalë dhe parashikohet të jepet në shfrytëzim për vitin 2022, me 26 vota pro me asnjë kundër, miratohet.

#### **Pika e VIII-të (Tetë) e rendit të ditës**

**z. Bexhet Xheladini** - para se ta propozoj një pik në këtë pikë eventuale, do ta bëjë një sqarim, një qytetar i Komunës sonë me emrin Fehim Sali, Asamblistët e më hershëm e njohin rastin dhe e din, por të rinjtë jo, por edhe zyrtarët komunal e dinë, Fehim Sali i është ankuar ombuds personit në Prishtinë dhe këtë ankesë OP e ka shqyrtuar, dhe me pas më kanë dërguar mu që të merrem me këtë lëndë dhe me këtë çështje, z. Sali pretendon se ju ka bo e pa drejt pasi ka bërë kërkesë për ndërtimin e një mini hidrocentrali dhe këtë kërkesë e ka dërguar në asamble, asambleja nuk e ka qitë në rend të ditës, ai ka vazhduar ku i ka bërë edhe 5 kërkesa ndër to edhe kryetarit të Komunës dhe këto të gjitha i ka shqyrtuar O-personi dhe ka kërkuar nga unë që të ndërmarr me këtë çështje dhe të sqarohet, pasi që un jam i ri dhe nuk kam qenë pjesë e këtij procesi propozoj që kjo asamble të merr një vendim për formimin e një komisioni, pasi që jam i obliguar që ombuds personit ti përgjigjem, të formojmë një komision prej 5 anëtarësh, shumica e këtij komisioni të jetë nga komuniteti jo shumicë dhe 2 të janë nga mandati i kaluar, një përfaqësues të jetë nga zyra e Kuvendit apo Kryetarit dhe një përfaqësues të jetë nga zyra e komuniteteve dhe një nga zyra e pranimit, unë po i propozoj disa emra nëse pajtoheni në rregull nëse jo mund ti ndryshoj, i pari është Munir Jonuzi, Naser Myrtezani, Suat Tosuni, Uzair Hamza dhe Sejat Emini.

**z. Uran Halimi** Ajo se çka ka të bëjë me hidrocentralet është procedurë e përfunduar edhe nga organet Komunale por edhe ato të pushtetit qendror, ku është ndaluar çdo veprimtari që ka të bëjë me hidrocentralet, dhe ata persona që i kanë bërë dëm duhet me dal para drejtësisë për me e paguar atë që e kanë bërë, propozimi i juaj nuk kalon pasi se nuk jeni person adekuat që me bo diçka të tillë, dikush tjetër mund ta bëjë por jo Kryetari pasi nuk ka të drejt me propozuar pika të rendi të ditës tek eventualet.

**Z, Artian Loshaj-** unë e di këtë rast pasi që kam qenë delegat i mandatit të kaluar, kjo punë është shumë serioze, dhe çështjet serioze ku u ngutët që kryesuesin me e shkarkuar në eventuale, ju jeni duke u ngutë, mirëpo në eventuale çështje si kjo shumë të rëndësishme, unë e njohë problemin dhe e di që ky



Kuvend ka marr vendim për ndalimin e ndërtimit të HC, po si çështje nuk mundet në eventuale me u shqyrtuar dhe me marr vendim. Qoftë se donë me i ndihmua thirre seancën e jashtëzakonshme ose një seancë me pikë të rendit të ditës po jo në eventuale është e pa kapshme, për seancën tjetër jam pro që kjo çështje të shkoj ma tutje.

**z.Samidin Xheladini-** Qellimi i kësaj çështje është shumë i mirë, pasi që ai ka të drejt me konkurrua por vendimi i Kuvendit ka qenë se për hir të reagimit të qytetarëve dhe Komunitetit Asambleja i ka aprovuar shqetësimet e qytetarëve të pjesës së gores dhe asambleja ka qenë unike pasi që komuniteti ka kërkuar që të mos ndërtohet HC dhe këto vendime janë të asamblesë ai i ka marr edhe i ka dërguar te O-P ku O-P kërkon nga na që zyrtarisht me ja que dokumentet zyrtare dhe për këtë Kryetari kërkojë një komision legjitim i cili do të merret me dokumentacionin ligjor për mos dhenien e lejes, thjesht kjo është që me e sqarua këtë çështje ke propozimi i kryetarit.

**z. Nexhmidin Sejdiçar-** Ne nuk jemi kundër diskutimit të këtyre çështjeve këtu, do të pajtohesh plotësisht me z. Loshaj, kjo nuk është një çështje që mund ta konsiderojmë ad hoc, Kryetari duhet të na dërgojë një ftesë dhe kështu të na përcjellë materialin që është dërguar nga Ombdperson, sepse ne tani e dimë vetëm atë që na ka shpjeguar Kryetari. Nuk kemi para nesh asnjë dokument që mund ta shqyrtojmë. Jam dakord që kjo është një çështje shumë e ndjeshme, sidomos në regionin e Gorës, sa i përket minihidrocentraleve, mendoj se komisioni prej 5 anëtarësh është shumë i vogël për ta zgjidhur këtë çështje. Duhet të jenë të paktën 9 ose 11 anëtarë, për të marrë parasysh edhe detajet më të vogla dhe për të marrë një vendim cilësor dhe të përshtatshëm si për investitorin ashtu edhe për popullatën. Është mirë që Kryetari ta përfshijë këtë pikë në rendin e ditës të seancës së ardhshme ose të caktojë një seancë të jashtëzakonshme dhe kështu t'na përcjellni materialin Ombdpersonit.

**z. Bexhet Xheladini -** unë kam propozuar të formohet komisioni dhe nuk e predikoj vendimin se çka ka me e marr komisioni, komisioni mund të punoj dhe me një mbledhje të ardhshme të Kuvendit, i dërgohet materiali edhe asamblesë edhe OP edhe e shqyrtoni dhe vendimi është i juaji se çfarë vendimi do të merrni, Unë jam i obliguar që ta paraqes këtë kërkesë në mënyrë që ta njoftoj OP, kjo nuk ka të bëjë me mu po por e kam gjetur, dhe nuk është çështje se unë po du me ja dhënë hidrocentralin, se ju ja keni dhënë 14 HC kujt keni deshtë e kur ka konkurruar një minoritar keni refuzuar, se unë as që kam me ja dhënë as që kam me marr për veti por me e sqaruar problemin se a i takon këtij HC a jo dhe për këtë e propozova këtë ekip për me sqaruar këto probleme dhe të gjithë janë të njëjtë.

**z. Uran Halimi -** rreth kërkesës së Kryetarit, është diçka e ndishme dhe ne nuk na përket të futemi në këto situata dhe unë e ftoj këtë qytetar që të merret me organet e drejtësisë që të merret me shkeljet e të drejtave të tij qoftë se ju është bërë e pa drejt, dhe ne duhet të i përmbahemi vendimeve që janë marr nga organet publike Qendrore dhe Komunale.

**z. Bexhet Xheladini -** Ombuds Personi ka kërkuar nga unë dhe Komuna, pasi që ky ka bërë ankesë për Komunën dhe OP ka mundur ti thotë ndiqi rrugët ligjore, OP ne jemi të obliguar me ligj të ju përgjigjemi në rrugë ligjore dhe komisioni ka me i vërtetuar pretendimet e z. Sali sa a janë të vëtetapo jo dhe e bie materialin ne asamble dhe keni me pas kohë 7 ditë me e shqyrtuar dhe asambleja e merr një vendim se çfarë e merr unë nuk e di.

**z. Uran Halimi** – ju z. Kryetar e keni shumë të lehtë me ja dërguar OP vendimet e kuvendit që janë miratuar në të kaluarën dhe ai është jashtë lojës, ta respektojmë një vendim që vet e kemi prurë vet e kemi votuar, ti OP mundesh me ja dhënë si shpajim një vendim të K. Komunes pjesa tjetër le të merren organet kompetente të drejtësisë.

**Artan Loshaj**- edhe na jemi për me i dhënë ndihmë qytetarëve, por dy vendime që i ka marr ky Kuvend na ka kthyer MAPL-ja, unë besoj se e dhe ky vendim me shti në komision ne këtë mënyrë nuk është mirë edhe nuk ke nevojë me u ngut, pikë së pari ti kompletojmë dokumentacionin me përkthime me krejt se përndryshe MAPL-ja na kthen prapë se ky vendim në eventuale nuk merret.

**z. Mehmet Spahiu**- pasi u nxita e morra fjalën, më duket se ka shumë paqartësi brenda disa asamblistëve, kryetari i Komunës e kërkoj formimin e një komisioni e jo të merret vendim, vendimi do të merrët pasi që komisioni do ti shqyrtoj të gjitha lëndët dhe të na kthehet neve të marrim një vendim, kryetari i Komunës është i obliguar ti përgjigjet OP deshëm a nuk deshëm ne, për këtë ne duhet ta formojmë komisionin.

**z. Uran Halimi** - po mendoj se kjo mundet me qenë një propozim për një pikë të rendit të ditës për një seancë të ardhshme, dhe OP Kryetari mund të ja dërgoj një vendim.

**Nexhmedin Sejdiç**- Unë e njoh shumë mirë z.Fehim Salin. Megjithatë, ne e dimë nga praktika se kjo është një temë shumë e ndjeshme, kështu që vendosja e kësaj pike nën pikë Eventuale më sjell dyshime. Ishte shumë e lehtë për Kryetarin, kur të bënte rendin e ditës mund të shtonte një pikë tjetër dhe gjithçka do të mbaronte. Kjo mënyrë më sjell dyshime. Unë sugjeroj, pasi Kryetari ka të drejtë ekskluzive ta caktojë vetë seancën, ta caktojë, të formojë një komision që do të shqyrtojë pretendimet e Avokatit të Popullit, të shqyrtojë pretendime të z. Fehim Sali dhe atë që ai ka për të thënë dhe pastaj të vijë në Kuvend për të marrë një vendim. Po ashtu, Kryetari ka mundur ta përfshijë atë që në fillim kur e lexoj komentin nga MAPL. Tani mund të flasim, të komentojmë, por nuk mund të votojmë, sepse nën pikën eventuale nuk merren vendime, ajo shërben për t'i bërë pyetje ekzekutivit.

**z.Naser Myrtezani**- ne nuk po mujm me marr një vendim po propozoj që të del në votim si kryesues i Kuvendit duhet me e qit në votim propozimin e Kryetarit, çka rrjedh ma tutje është komisioni që do të formohet vjen në Kuvend propozohet, shqyrtohet, ti si kryesues je i obliguar ta qesësh ne votim edhe të votohet.

**z. Uran Halimi** - sa i përket procedurave te rendi ditës neni 47 pika 47.2 ( anëtari i kuvendit të komunës ka të drejtën të shtoj pik gjatë seancës së rregullt) pika që kërkohet është çështje urgjente dhe me rëndësi publike. çfarë urgjence ka këtu?!!

**z.Samidin Xheladini**- ti shumë mirë e ceke ligjin, nenin dhe ligji është 47.2 edhe 47.3 ( ankesa e tilla mund të refuzohen ose të miratohen me votën e shumicës) ki për obligim me ju përmbajt ligjit , qite në votim.

**z. Uran Halimi** - zotëri po e përsëris anëtari i Kuvendit të Komunës ka të drejtën të shtoj pik gjatë seancës së rregullt pika që kërkohet është çështje urgjente dhe me rëndësi publike. çfarë urgjence ka

qetu?!! Edhe neni 47.3 ankesa e tilla mund të refuzohen ose të miratohen me votën e shumicës por pika paraprake po thotë se nëse çështja është shumë urgjente dhe me rendësi të madhe publike ku është rëndësia publike? Dhe unë pe shti në rend të ditës. Kryetari nuk ka drejt me shti pika të rendit të ditës veç antari ka të drejt.

**Mehmet Spahiu-** këtu nuk është në pyetje anëtari i Kuvendit kërkesën e ka bo Kryetari dhe kjo duhet të del në rend të ditës, Kryetari e konsideron se duhet të jetë në rend të ditës edhe kaq, edhe diçka z. Nexho komisioni nuk merr vendim komisioni e shqyrton materialin dhe ja rikthen serish Kuvendit Komunal.

**Nexhmidin sejdillar-** Këtu i kemi ngatërruar gjërat, sepse rendi i ditës votohet në fillim të seancës dhe jo në fund. Ju mund të vendosni një pikë në rendin e ditës në fillim dhe jo në kuadër pikës eventuale. Së dyti, po thoni se nuk dëshironi të merrni vendim, dhe në anën tjetër thoni se dëshiron të futni këtë çështje në votim, logjikisht kur diçka vihet në votim, merret vendim. Nuk mund të votojmë diçka pa marr Vendim. Ndoshta jam budalla dhe nuk i kuptoj disa gjëra. E hedhim në votim dhe nuk marrim një vendim si mund të bëhet?. Do të thotë se deri më tani nuk është marrë asnjë vendim me votim. Për çfarë kemi votuar, asgjë. Ajo që kemi votuar deri më tani, janë ato vendime apo jo?. Unë nuk jam kundër z. Fehim Sali, që t'i formohet një komision, nuk mund të krijohen komisione në kuadër pikës eventuale. Ishte shumë e lehtë për Kryetarin, ai formon rendin e ditës, mund të vendoste një pikë mes pikave, pastaj do të debatonim dhe të formonim një komision.

**Xhyllferie Batjari-** pasi që po bazohemi në ligje kërkohet që njëri ose dikush nga anëtarët e Kuvendit të propozoi të jep një propozim në pikën eventuale, kërkohet që të formohet ky komision për shqyrtimin, ndërsa sa i përket rëndësisë varet se si e shohim, prandaj unë kërkohet që të formohet ky komision në pikën eventuale dhe pastaj le ta shqyrtojmë në Kuvend.

**z. Shpejtim Hajredini-** ne po kalojmë shumë kohë duke debatuar për çështje që janë të precizuara nga ligji dhe për çështje që ekzekutivi e din që janë të përcaktuara, pse nuk e propozoni dhe e futni me kohë në rend të ditës dhe na e diskutojmë gjatë rendit të ditës pa problem, por në eventuale këto çështje nuk futën edhe diskutohen, mos vazhdoni në këtë formë, nxirrni këto pika në rend të ditës sipas rendi të ditës diskutojmë e jo kështu.

**Samidin Xheladini-** prej përvojës po e them që në pikat eventuale kemi marr vendime shumë me më rendësi, pasi që e kemi obligim ligjor e moral dhe qoftë se ka kërkesë të arsyeshme çdo kush ka të drejt të propozoj pika në eventuale edhe qytetari dhe na jemi këtu me i shqyrtua bile na si opozitë i kemi votuar. Këtu po kërkohet që qeto vendime që janë marr me dal ne Kuvend edhe me ja dërguar OP edhe me dal na si Komunë para tyre nuk ka qellim tjetër.

**Shpejtim Hajredini-** ju si ekzekutiv po lejoni të dalim nga vetvetja, të marrim kohën dhe të debatojmë kotë, hudhne në votim i keni votat dhe ne po vazhdojmë në seancat e ardhshme me punuar për popullin.

**z. Uran Halimi** po e përsëris se shtimi i rendit të ditës bëhet si çështje urgjente, ma jepni urgjencën, unë sipas ligjit po kërkohet të jetë çështje urgjente.

z. Bexhet Xheladini Po me vjen keq që kjo çështje u politizua aq shumë, por ju thash që këtë çështje e kam gjetur kështu që e keni bo ju, dhe unë jam i obliguar me ligj që të merrem me këtë çështje, OP e kam informuar se do të propozoj formimin e komisionit se a formohet ky komision a jo nuk është çështje e imja, z.Munir Jonuzi nuk donë të jetë në komision tërhiqet, në vend të tij propozoj të jetë z.Muralem Rahte kaq.

**z. Uran Halimi** - atëherë votojmë kush është pro propozimit të zonjës Xhylferie Batjari.

**Artan Ioshaj**- ju i keni votat edhe e kaloni por z. Sali po e qitni në lajthitje sepse ky vendim i juaji ka me u kthe nga MAPL-ja dhe ju e keni me e bo një arsyetim se na e bëmë por Ministria e kthej prapa, unë dua që zotërisë me i bo zgjidhje dhe kam me ja votuar në një seancë të rregullt, po kjo është shumë gabim se Ministria ka me kthyer prapë dhe ju keni me u shfajësuar.

**z. Naser myrtezani**- një pauzë 5 minuta.

**Jetmir Ajdini**- kërkojë nga Kryetari që të del dhe ta sqaroj kërkesën e OP rreth kësaj çështje.

**Munir Januzi**- Përshëndetje të gjithëve, po ju drejtohem si nënkryesuesi i komunitetit joshumicë, e kam theksuar pozitën, pasi është në pyetje një person nga komuniteti joshumicë. Të gjithë opozita apo pushteti mbështesim çdo lloj investimi në komunën tonë. Sigurisht që këto investime duhet të jenë në përputhje me ligjet, UA dhe rregulloret tjera në fuqi. Kjo është një çështje shumë e rëndësishme dhe e ndjeshme, prandaj rasti ka mbërritur te Avokati i Popullit. Pyetja se a kemi bërë ndonjë padrejtësi, ne që ishim në përbërjen e fundit të Komitetit për Komunitete, që e kemi shqyrtuar këtë rast, prandaj kam kërkuar që të mos jem në këtë komision, sepse kam qenë pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në vendimet e marra në lidhje me HD. . Le të shqyrtojnë anëtarët e rinj të komisionit nëse i kemi bërë ndonjë padrejtësi z. Fehim. Duke qenë se ai është pjesëtar i një komuniteti joshumicë, duhet ta trajtojmë këtë temë më në detaje. Duhet të marrë vendimin e Avokatit të Popullit, për ta lexuar atë, komisioni që do të formohet, për të shqyrtuar nëse kemi bërë gjithçka në përputhje me ligjin. Dhe nëse e sheh të arsyeshme, të lejojë, për të mos i paragjykuar gjërat, ndërtimin e ndonjë HD të ri, sepse ne thamë jemi të gjithë për investime në këtë Komunë. Prandaj i sugjeroj Kryetarit që të caktohet një kuvend i posaçëm, ose ta shqyrtojmë këtë problem në ndonjë mbledhje tjetër të rregullt apo të jashtëzakonshme, sepse askujt nuk duhet t'i bëhet padrejtësi. Jemi këtu për të punuar në interes të qytetarëve, ndoshta diku kemi gabuar, vetëm dua që ky rast të konsiderohet si një rast i izoluar dhe si një rast që ndodhi para se të miratohej ndalimi për ndërtimin e HD-ve të reja.

**Xhylferije Batjari**- unë po kërkoj tërheqjen e propozimit tim pasi propozimi i minoriteteve është shumë me rëndësi për ne dhe kjo çështje ka të bëjë me këtë komunitet.

**Nexhat Sele**- kërkoj nga Kryetari një sqarim ma të detajuar, kjo çështje është pak e ndërlikuar. Nëse ka mundësi që kjo çështje të trajtohet në një seancë të jashtëzakonshme apo si pikë e veçantë e një seance të rregullt që të kemi kohë dhe të na dërgohet nga një dokumentacion lidhur me këtë problem, ne po e shohim se ka disa paqartësi, mos ka ndonjë prapavijë ma serioze, pasi që kemi se me çka të merremi në eventuale nuk e di a është shumë urgjente ti kthejmë një përgjigjeje OP se sa që kemi shumë urgjente situatat që i kemi dhe duhet ti debatojmë në këtë pikë eventuale. Siç e shini ne jemi në një luftë,

që po i shkakton probleme popullatës. Pra ta lejmë për një seancë të radhës dhe të merremi me probleme të tjera.

**z. Uran Halimi** - kush është pro që kjo çështje të jetë pikë e veçantë e rendit të ditës me të gjitha 27 vota pro, miratohet.

**Sefidin Mejzini**- e kam një propozim dhe kërkesë, ky Kuvend ku po punojmë ka nevojë për perde dhe kushte ma të mira, pasi po reflekton drita edhe nuk kushton ti vendosim perde.

**Artan Ioshaj**- pasi që ju si pozitë po ju bjenë shpesh me u tërhjek, e po e shini se na si opozitë e kemi mirë edhe po doni me e qitë në lajthitje qytetarin po na kemi me i ndihmu zotërisë, dhe sa po i boni numrat po filloni me kërcënime por me qit në rend të ditës dhe ky fjalor i tij nuk me pëlqej dhe është një vërejtje publike se na 14 vjet na keni kërcënuar si opozitë e na nuk kemi mu sjell si ju kemi me ju ndihmue ku duhet, te investimet kapitale si do të aj boni se për 14 vite 24 milion i keni kthyer prapë e ju sivjet sa para keni me i kthyer prapë duke e pa se sipas planit tuaj të gjitha investimet kapitale do të bëhen në fillim të muajit shkurt me i hap tenderët a janë hap tenderët sa tenderë e dini mirë se OSHP- ja nuk e ka bordin e formuar me para masa qysh keni me ja bo se krejt i njëjti sistem është dhe ju e keni me i kthyer sistemin e participimit duke e ditur se qytetarët janë të varfër me participuar për me bo plane për investime, studios i ka kaluar mandati 2 vjeçar dhe e kanë zgjedhur dikënd tjetër dhe ai ka bo ankesë dhe ankesa e personit tjetër është në OSHP si keni me ja bo ju? Kanë mbet disa projekte të rrugëve, për studionin që i ka premtuar kryetari 50 mi euro e na kemi bo gabime qysh keni me ja bo ku keni me i marr parat, plani i drejtorit nuk përputhet me planin e K.K-së dhe disa kode janë të larguara nga aty pse është bo kjo? Pse janë hjek këto para mos janë avulluar?....

**z. Bexhet Xheladini** - Të njëjtat pyetje Artani i ka bo edhe në Komitet dhe unë jam përgjigjur, na gjenden e projekteve e kemi gjetë kështu, pasi K.K e kalume i ka miratuar dhe prej 97 propozimeve vetëm 7-8 kanë pas projekte dhe shuma e cila është caktuar nuk po përputhet me projektin pasi është vendosur paushall unë si Kryetar jam to u marr seriozisht me këto çështje ku kam organizuar disa takime për hartimin e projekteve nuk po merremi me para masa edhe parallogari jemi duke punuar në të gjithë territorin e Komunës dhe jemi në fund të hartimit dhe zyra e prokurimit ka filluar shpalljen e projekteve ku 15 janë shpallë dhe deri në fund të prillit do të shpallen të gjitha sa për OSHP ajo nuk është çështje e jona, e jona është që projektet mos të na shkojnë në OSHP. Sa për stadionin një komision ka qenë e i ka vizituar edhe stadionin edhe shkollën e mesme në stadion edhe pse janë bërë shumë investime situata është shumë e rënd është punuar ad hok, por ne do të merremi në mënyrë shumë serioze, dhe kemi marr një vendim që KF Opoja ti ndihmojmë edhe me mjete materiale, por edhe rruga deri te stadioni të zgjerohet gjithashtu do të merremi me shkollën profesionale në të ardhmen, sa për projektet që janë kthyer ato projekte i kemi gjetur të kthyer pse është bërë kjo nuk e di ndoshta nuk kanë pas mjete, projektet janë kthyer por mjetet janë dhe këto para do të ri destinohen në projekte të reja dhe vendimi është i asamblesë se çka do të bëjnë me këto projekte. Sa për trotuarin e rrugës është çështje e Ministrisë dhe do ta diskutojmë me ta, sa për piken që u tërheq unë kam bo propozim ndërsa vendimi është i K.K sa a don me e marrë këtë vendim a jo.

**Sefidin Mejzini**-roli i opozitës është me dal sa ma shpesh në foltore, unë kam raporte të mira me të gjithë, edhe një send mos pritni ndonjë performancë të mirë të qeverisjes tonë këtë vit, se janë projekte të qeveris së kaluar dhe ka porjekte me 5.000 euro e tash çmimet kanë ndryshuar e çka me bo, edhe diçka duhet të kemi kujdes me fjalorin.

**Nexhmidin sejdillar**- Duke qenë se jemi në pikën Eventuale, lus Kryetarin që të dalë në foltore dhe të prezantojë kabinetin e tij. Cilët drejtorë ka, nga cila parti janë, mendoj se ne si këshilltarë që jemi këtu nuk jemi të informuar e lëre më qytetarët.

**z.Naser Myrtezani**- Çështja e miqësisë është tjetër kur jemi në K.K jemi oponent politik edhe ne i mbrojmë interesat e partive politike, ndërsa atë që e kam bo në mandatin e kaluar e kam bo që juve me ju dërguar në opozitë dhe sot jam i relaksuar që ja kemi arritur qëllimin, ju lus për durim sepse për këtë vit do të merremi me pislëqet e juaja që i keni lënë gjatë qeverisjes së kaluar rast konkret shuajtat e punëtoreve të arsimit që janë paraparë nga viti 2017 dhe janë në pyetje 800.000€ deri 900.000€ dhe kjo është barrë për qeverinë e re, dhe projektet tjera ku janë filluar projektet dhe asnjë nuk është finalizuar se kanë filluar gjatë fushatës zgjedhore, opozita duhet ta din se Kryetari e ka filluar punët konkrete që nga pastrimi i rrugëve nga bora si punë shembull pa vërejtje ku janë pastruar edhe rrugët Zaplluxhe-Lez-Prizren edhe rruge Brrut- Trokon që ma herët nuk janë hapur kurrë, desha ti falënderoj Kryetarin për organizimin e festave të fillim vitit dhe për këtë i falënderoj në emrin tim si mësimdhënës dhe për vizitën që na keni bërë për 7 mars dhe kjo është hera e par që ndodh.

**Nexhat Sele**- Nga Kryetari edhe ma herët kërkova të marr një sqarim për dikasterin e bujqësisë, nuk e di se a ekziston shtabi i krizës kisha kërkuar në seancën e radhës nga drejtoria e bujqësisë të na nxjerre sipërfaqet e tokave të pushueshme të mbjellura dhe në një seancë të radhës të shikojmë se a kemi mundësi të ju ndihmojmë sektorit të lavërtarisë por sipas meje ne kemi mbi 500 hektar toka të punueshme dhe kjo krizë që na ka kapluar që në shtator të përgatitemi që mund ti stimulojmë lavërtarët që ta punojnë tokën dhe sipas llogaritjes sime besoj se deri më 50% të konsumit ditor mund ta sigurojmë vet, pra të marrim vendim të ju ndihmoj lavërtarëve.

**Shpejtim Hajredimi**- sa i përket akuzave të ekzekutivin e kaluar edhe unë e kam kritikuar Kryetari i komunës perse i ka mbështetur ato fshatra që janë udhëheq nga këta asamblastë edhe unë personalisht i kam ndihmuar disa personave dhe sot të thuhet së qeverisja e kaluar ka dështuar në menaxhimin e projekteve dhe ti kritikojmë edhe këta që kanë ardhur tash kanë me punuar shumë, unë po befasohem me këta kur e dimë se me buxhetin që e kemi nuk mundemi me e bo këtë diferencë, të hyrat që i kemi pasur nga kjo qeveri nuk kanë me mund ti bëjë sepse në kemi pasur projekte kapitale mbi 8 milion dhe këta nuk kanë shanse të bëjnë këto, pra punoni për qytetarët që janë mbet e të mos ikin. Mos u merrni me ekzekutivin e kaluar se krejt gabojmë sepse ish kryetari ka punuar ma shumë me ju edhe ju ka pritur juve ma shumë.

**Sefidin Mejzini**- Unë thash që vitin e parë mos pritni ndonjë performacë tonën pasi projektet kanë qenë të kaluara për vitin e 2,3,4 atëherë lypni performancë, në këtë qeverisje do të mbrohen interesat e qytetarëve e jo të zyrave të partive pasi vota është marr nga qytetari.

**Agron Gashi-** Rreth prioriteteve të fshatrave që janë marr, qoftë se e shikojmë buxhetin për vitin 2022- 2024 janë marr shumë prioritete por ato prioritetet kanë të bëjnë me kubizmin e rrugëve dhe me kubzim Komuna jonë prin , por mos të harrojmë se fshati Brezne nuk ka ujë të pijshëm, aty mungojnë edhe shumë gjera të tjera si çerdhja, fushat e sportit mirëpo qeverisja paraprake i ka dhënë prioritet edhe varrezave pra nuk ka pas projekte të mirëfillta dhe mendoj sende me ma prioritetet dhe nuk kam marr asnjë informatë. Dhe tash do të kemi pasoja rreth projekteve pasi nuk jemi marr me prioritete.

**Artan Loshaj-** z. Sefidin nuk pres nga ju shumë se ne kemi bo gabime dhe ju keni me i vazhdua. Sa i përket Naseri u ndjeva i frikësuar me qasjen e tij pasi përmendi fëlliqësira atëherë më preki se mu duk se e tha me qëllim qoftë se jo atëherë ja fali.

**z. Uran Halimi** – E shapalli këtë seanc të mbyllur!

*Kryesuesi i Kuvendit: Uran Halimi*

---